REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

P R O J E K T L I G J

Nr._____/2026

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.103/2016 "PËR AKUAKULTURËN" I NDRYSHUAR,

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 103/2016, "Për akuakulturën", i ndryshuar bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

"Kudo në ligjin, fjala 'aktivitet' zëvendësohet me fjalën 'veprimtari'.

Neni 2

Në nenin 3 bëhen shtesat si më poshtë:

1. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1, 1/2, 1/3 dhe 1/4 me këtë përmbajtje:

"1/1. "Akuakulturë në ujërat e brendshme" është kultivimi ose mbarështimi i organizmave ujorë në ujërat e brendshme, sipas përcaktimit të pikës 11 të këtij neni.

1/2. "Akuakulturë tokësore" është akuakultura që zhvillohet në sipërfaqe tokësore, nëpërmjet instalimeve tokësore, sistemeve të kontrolluara të prodhimit ose teknologjive të tjera të përshtatshme, duke përdorur ujë të ëmbël, ujë të njelmët ose ujë deti, sipas llojit të organizmave ujorë që kultivohen.

1/3. "Akuakulturë detare" është kultivimi ose mbarështimi i organizmave ujorë në mjedise ujore detare, përfshirë zonat bregdetare dhe hapësirat detare të përcaktuara për këtë qëllim.

1/4. 'Akuaponi' është një sistem i integruar bujqësie dhe akuakulture, që kombinon rritjen e organizmave ujorë, peshq ose kultura të tjera ujore, si dhe kultivimin e bimëve në një cikël të mbyllur, ku mbetjet e organizmave ujorë përdoren si lëndë ushqyese për bimët, ndërsa bimët ndihmojnë në pastrimin e ujit për organizmat ujorë.

2. Pas pikës 19 shtohet pika 20 me këtë përmbajtje:

"20. "Sitemet e integruara prodhimi" janë forma te veprimtarisë të akuakulturës në të cilat kultivohen njëkohësisht dhe në mënyrë të ndërlidhur specie të ndryshme ujore, si peshq, molusqe, jovertebrorë, alga ose bimë ujore, me qëllim shfrytëzimin e përfitimeve reciproke biologjike dhe ekologjike, optimizimin e përdorimit të burimeve, riciklimin e lëndëve ushqyese dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë mjedisore dhe ekonomike të fermës së akuakulturës."

Neni 3

Ne nenin 4, pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

'1. Miratohen nëpërmjet një sistemi planifikimi që synon integrimin e veprimtarise të akuakulturës në zonë ujore detare me përdoruesit e tjerë, për të shmangur konfliktet në përdorimin e këtyre zonave."

'2. Zbatohen për të lehtësuar dhe zhvilluar veprimtarine e akuakulturës në zonat ujore detare duke përfshirë, procesin e lejimit dhe të procedurave të funksionimit."

Neni 4

Në nenin 5, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. ZPA-ja përfshin zona të veçanta ujore detare, të caktuara për zhvillimin e veprimtarise të akuakulturës detare, së bashku me infrastrukturën në shërbim të saj.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me përmbajtje si vijon:

"1/1. Instalimet ne pronësi shtetërore te vendosura ne sipërfaqe detare, ujera te brendshme dhe sipërfaqe tokesore konsiderohen si Zona te Përcaktuara për Akuakulture."

3. Pika 2, ndryshohet si më poshtë:

"2. ZPA-ja përgatitet dhe koordinohet me nismën e ministrisë, në konsultim me ministritë përgjegjëse në fushën e planifikimit të territorit, përdorimit të hapësirës detare, transportit, përdorimit të burimeve ujore, mbrojtjes së mjedisit, turizmit, ekonomisë dhe trashëgimisë kulturore. Zonat e përcaktuara për akuakulturë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Nëse një ZPA e propozuar shtrihet në një zonë kufitare me një zonë të mbrojtur, procesi i miratimit të saj nga këshilli i Ministrave, duhet të përfshijë një konsultim publik me grupet e interesit dhe institucionet shkencore."

4. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. ZPA-ja është pjesë e planifikimit fizik të hapësirës ujore detare, kriteret për përgatitjen e së cilës mbajnë parasysh faktorët që e lejojnë zhvillimin e akuakulturës dhe faktorët që nuk e lejojnë zhvillimin e saj."

5. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

"5. Të dhënat e përdorura për ZPA-të janë me vlerë jo vetëm për përdoruesit që lidhen drejtpërdrejt me akuakulturën, por edhe për përdoruesit e tjerë publikë të hapësirës detare.

Neni 5

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 8
Veprimtaria e akuakulturës

1. Veprimtaria e akuakulturës zhvillohet nga persona fizikë ose juridikë, të cilët kanë akuakulturën për objekt të veprimtarisë, në:

   a) zona ujore detare të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave si ZPA;

   b) ujëra të brendshme;

   c) sipërfaqe tokësore publike ose private.

2. Ushtrimi i veprimtarisë së akuakulturës në ujëra të brendshme dhe në sipërfaqe tokësore nuk kushtëzohet nga miratimi i zonës si ZPA.

3. Sistemet e integruara te prodhimi te akuakultures mund te zhvillohen ne zonat ujore detare të miratuara si ZPA, pavarësisht kategorizimit te tyre, ne ujerat e brendshme dhe ne sipërfaqet tokësore publike ose private.

4. Personat fizikë ose juridikë, të interesuar për zhvillimin e veprimtarisë të akuakulturës në zona ujore detare të miratuara si ZPA, në ujëra të brendshme ose në sipërfaqe tokësore publike, u nënshtrohen procedurave të konkurrimit publik, përveç rasteve të rinovimit të kontratës sipas parashikimeve të nenit 25 të këtij ligji.

5. Personat fizikë ose juridikë, të interesuar për zhvillimin e veprimtarisë të akuakulturës në sipërfaqe tokësore private, nuk i nënshtrohen procedurave të konkurrimit publik dhe lidhin kontratë me ministrinë, sipas parashikimeve të nenit 14 të këtij ligji.

6. Ministria lidh kontratë për të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë të akuakulturës me subjektin fitues të procedurës së konkurrimit publik ose me subjektin që plotëson kushtet për ushtrimin e veprimtarisënë sipërfaqe tokësore private.

7. Personat fizikë ose juridikë, pas lidhjes së kontratës me ministrinë, duhet të pajisen me licencën përkatëse sipas kritereve dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

8. Institucioni që vlerëson plotësimin e kushteve të licencimit ose revokimin e licencës për veprimtarinë e akuakulturës është struktura përgjegjëse për akuakulturën në ministri.

9. Veprimtaria e akuakulturës ushtrohet nga personat fizikë ose juridikë, vetëm pas lidhjes së kontratës përkatëse dhe pajisjes me licencën sipas këtij ligji.

10. Kriteret teknike për ushtrimin e veprimtarisë të akuakulturës në ujëra të brendshme, në sipërfaqe tokësore publike ose private dhe në sisteme të integruara prodhimi miratohen me Vendim te Këshillit te Ministrave."

Neni 6

Pas nenit 8 shtohet neni 8/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 8/1
Sistemet e akuaponisë

1. Veprimtaria e akuakulturës mund të zhvillohet edhe në forma të integruara prodhimi, përfshirë sisteme akuaponie, të cilat kombinojnë kultivimin ose mbarështimin e organizmave ujorë me kultivimin e bimëve në sisteme të kontrolluara.

2. Veprimtaria e akuaponisë mund të zhvillohen në instalime tokësore, publike ose private, si dhe në struktura të kontrolluara prodhimi, përfshirë serrat, sistemet me riqarkullim të ujit dhe teknologji të tjera të përshtatshme.

3. Subjektet që zhvillojnë veprimtarinë e akuaponies duhet të pajisen me kontratën për të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë të akuakulturës dhe me licencën përkatëse, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet.

4. Kur zhvillimi i veprimtarisë të akuaponisë kërkon përdorimin e burimeve ujore, ndërtimin ose vendosjen e instalimeve, shkarkimin e ujërave, ose ndërhyrje të tjera te rregulluara nga

legjislacioni i posaçëm, subjekti pajiset edhe me lejet, autorizimet ose miratimet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Kriteret teknike për ushtrimin e veprimtarisë të akuaponise miratohen me Vendim te Këshillit te Ministrave."

Neni 7

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 9
Dhënia në përdorim ose me qira e pronës tokësore publike

1. Prona tokësore publike, përfshirë dhe atë në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore mund t'u jepet në përdorim ose me qira personave fizikë ose juridikë për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës ose për ushtrimin e veprimtarive ndihmëse që lidhen drejtpërdrejt me të., sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi për administrimin dhe dhënien në përdorim ose me qira të pronës shtetërore ose vendore.
2. Ministria lidh kontratën për të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë të akuakulturës me subjektin fitues, pasi subjekti të ketë fituar të drejtën e përdorimit ose të qirasë mbi pronën tokësore publike, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Të ardhurat nga qiradhënia e pronës tokësore publike derdhen përkatësisht në Buxhetin e Shtetit ose në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Vlera e qirasë për pronën tokësore publike përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi për administrimin dhe dhënien me qira të pronës publike.
5. Kontrata për të drejtën e ushtrimit të veprimtarise të akuakulturës nuk zëvendëson lejet, miratimet ose autorizimet ekerkuara sipas legjislacionit në fuqi

Neni 8

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 10
Dhënia në përdorim e sipërfaqeve ujore

1. Sipërfaqet ujore detare të miratuara si ZPA dhe sipërfaqet ujore të brendshme mund t'u jepen në përdorim personave fizikë ose juridikë për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.
2. Kushtet e përdorimit e sipërfaqes ujore përcaktohen në kontratën për të drejtën e ushtrimit të veprimtarise të akuakulturës që ministria lidh me subjektin fitues, në përputhje me kete ligj dhe legjislacionin në fuqi.

Vlera e qirasë për sipërfaqet ujore detare te miratuara si ZPA dhe për sipërfaqet ujore të brendshme përcaktohet me udhëzim te përbashkët te ministrit përgjegjës për akuakulturën dhe ministrin përgjegjës për financat.

Neni 9

Neni 11 shfuqizohet.

Neni 10

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 12
Kushtet e kultivimit

1. Personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e akuakulturës në zona ujore detare të përcaktuara si ZPA, në ujëra të brendshme ose në sipërfaqe tokësore, e zhvillojnë veprimtarinë vetëm në zonën ose sipërfaqen e përcaktuar në kontratën për të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë të akuakulturës.

2. Personat fizikë ose juridikë kultivojnë vetëm llojet e peshkut ose organizmash të tjerë ujorë, brenda kufijve sasiorë të përcaktuar në kontratë.

3. Me kërkesë të subjektit, kontrata për të drejtën e ushtrimit të veprimtarise të akuakulturës mund të ndryshohet me marrëveshje ndërmjet palëve për ndryshimin e llojeve ose rritjen e sasisë së peshkut dhe organizmave të tjerë ujorë, kur këto ndryshime janë në përputhje me kapacitetin mbajtës ose prodhues të zonës ose sipërfaqes ku ushtrohet veprimtaria, dhe me kushtet mjedisore.

4. Ndryshimet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, miratohen pas vlerësimit teknik nga struktura përgjegjëse për akuakulturën në ministri dhe, kur është e nevojshme, pas marrjes së mendimit ose miratimit nga institucionet përgjegjëse për mjedisin, burimet ujore, sigurinë ushqimore dhe shëndetin e kafshëve ujore.

5. Ndryshimi i llojeve të peshkut ose organizmave të tjerë ujorë nuk lejohet kur llojet e propozuara i nënshtrohen regjimit të veçantë të parashikuar në nenet 28, 29 dhe 30 të këtij ligji.

Neni 11

Neni 13 riformulohet si vijon:

1. Kohëzgjatja e kontratës për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës në sipërfaqet tokësore dhe ujore është 20 vjet.
2. Ne rastin e veprimtarisë së akuakulturës në sipërfaqet tokësore publike, kohëzgjatja e kontratës për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës është e njëjtë me kontratën e shfrytëzimit te sipërfaqes tokesore, pa tejkaluar 20 vjet.
3. Në kontratë parashikohen afatet, brenda të cilave duhet të fillojnë e të përfundojnë veprat për ushtrimin e veprimtarisë. Në çdo rast, veprat duhet të përfundohen brenda tre vjetëve nga çasti i nënshkrimit të kontratës përkatëse.

Neni 12

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 16
Përfitimi i së drejtës së ushtrimit të veprimtarisë se akuakultures

1. Ministria shpall konkurrimin publik për dhënien e së drejtës së ushtrimit të veprimtarisë të akuakulturës në:

a) zona ujore detare të përcaktuara si ZPA, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) ujëra të brendshme;

2. Çdo person fizik ose juridik aplikon për të përfituar të drejtën e ushtrimit të veprimtarise të akuakulturës në zonat dhe sipërfaqet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, aplikojnë sipas procedurave të konkurrimit publik, të parashikuara në këtë ligj.
3. Menyra dhe procedurat e fitimit te se drejtes së ushtrimit të veprimtarisë se akuakultures ne sipërfaqe tokesore publike përcaktohen me Vendim te Këshillit te Ministrave

Neni 13

Ne nenin 20 behën këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:

"b) me humbjen e personalitetit juridik të personit juridik ose me çregjistrimin nga regjistri tregtar të personit fizik;".

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Në rast të humbjes së personalitetit juridik të personit juridik ose të çregjistrimit nga regjistri tregtar të personit fizik, sipas shkronjës "b", të pikës 1, të këtij neni, subjekti ose përfaqësuesi i tij ligjor njofton menjëherë ministrinë.

Neni 14

Neni 22 shfuqizohet

Neni 15

Në nenin 23, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Në rastet e ndërprerjes ose zgjidhjes së kontratës për ushtrimin e veprimtarise të akuakulturës në sipërfaqe ujore ose tokësore publike apo private, autoriteti përgjegjës njofton edhe institucionin përgjegjës për administrimin e pronës ose sipërfaqen përkatëse."

Neni 16

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 24
Përfundimi i kontratës

1. Kontrata për të drejtën e ushtrimit të veprimtarise të akuakulturës përcakton afatin e vlefshmërisë së saj. Pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë së kontratës, zona ose sipërfaqja përkatëse shpallet për konkurrim publik, pasi është marrë më parë edhe mendimi i institucioneve përkatëse të përfshira në këtë proces, me përjashtim të rastit të rinovimit të kontratës sipas nenit 25 të këtij ligji.

2. Në rastin e veprimtarise të akuakulturës në sipërfaqe tokësore private, pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë së kontratës, subjekti mund të aplikojë për lidhjen e një kontrate të re, sipas procedurës së parashikuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, me përjashtim te rastit te rinovimit te kontratës sipas nenit 25 te këtij ligji."

Neni 17

Në nenin 25 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2, shkronja "c" ndryshohet si më poshtë:

"c) kërkesa për rinovimin e kontratës nuk është në përputhje me dokumentin e ZPA-së, për zonat ujore detare, ose me kriteret teknike, kushtet mjedisore, përfshirë kapacitetin mbajtës apo prodhues të zonës apo sipërfaqes përkatëse".

2. Pas shkronjës "d" shtohet shkronja "dh", me këtë përmbajtje:

"dh) ushtruesi i veprimtarisë ka detyrime të pashlyera që rrjedhin nga kontrata ose nga legjislacioni në fuqi."

Neni 18

Aktet nënligjore

Ne nenin 49, pas pikës 2, shtohen pikat 3 dhe 4 me përmbajtje si vijon:

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për miratimin e akteve nënligjore në zbatim të pikës 10 te nenit 8, pikës 5 te nenit 8/1 dhe pikës 3 te nenit 16, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
4. Ngarkohet ministri përgjegjës për akuakulturën dhe ministri përgjegjës për financat për miratimin e aktit nënligjor në zbatim të nenit 10, pika 3, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

NIKO PELESHI